

Viti 2020

ANALIZË VJETORE



**INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE
SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

<http://inspektoriatipunes.gov.al/>

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
MISIONI	3
QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	4
PËRMBLEDHJE	5
RAPORTIME SIPAS DEPARTAMENTEVE	8
Tregues statistikorë të inspektimeve të punës	8
Punësimi informal	13
Ankesat, kërkesa dhe informacion sqarues mbi detyrime ligjore të punës	15
Aksidentet në punë dhe për shkak të saj	16
Sigurisë dhe shëndetit në punë	20
Inspektimi shoqëror për plotësimin e Standarteve të Përkujdesit	21
Departamenti Juridik	23
Departamenti i Burimeve Njerëzore	25
Departamenti i Financës	27
AKTIVITETE	29
PROBLEMATIKAT E HASURA	31
OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS	32

HYRJE

Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është organ i qeverisjes qendrore, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, që në vitin 1994. Aktualisht institucioni është në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe ushtron veprimtarinë inspektuese bazuar në objektivat e miratuara institucionale, dhe konform procedurës inspektuese të Inspektoriatit Qëndror. Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, përmes veprimtarisë inspektuese bazuar në Ligjin 10433/2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligjin 9634/2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar, kërkon zbatimin e legjislacionit të punës nga të gjithë, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Sfidë e institucionit, gjatë vitit 2020, krahas objektivave të përcaktuara nga një vit më parë, me një mirë orientim të inspektimeve në subjekte me historik e probleme mbi zbatimin e legjislacionit të punës me historik aksidenti në punë, me historik problematike në lidhje me marrëdhëniet e punës, ishtë dhe përballja me një vit të pazakontë për shkak të pandemisë, i cili i dha një qasje ndryshe dhe më informuese e këshilluese ndaj bizneseve, punëdhënësve e punëmarrësve. Krahas fushës së inspektimit të punës, pjesë përbërëse e Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore që prej vitit 2012 është dhe Inspektimi i Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, me përgjegjësi dhe kompetencë për inspektimin e standarteve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Ky raport do të analizojë veprimtarinë e Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe të dhënave të inspektimit e treguesve për Vitin 2020.

KRYEINSPEKTOR

ARDIT KAJA

MISIONI

Misioni i përgjithshëm i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është: kontrolli, konstatimi, këshillimi, njoftimi, formimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimi. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ngarkohet:

- ✓ Të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave.
- ✓ T'u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efikase të shqyrtimit të dispozitave ligjore.
- ✓ Të vërë në dijeni autoritetin përgjegjës për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes.
- ✓ Të sigurojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Viti 2020, për shkak të pandemisë mbarë botërore, u karakterizua me shumë të patritura e me zhvillime në marrëdhënie punësimi e kushte pune të diktuar nga kjo situatë, e që ndryshonin në kohë, në varësi zhvillimeve të krijuara nga covid-19. Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në përshtatje me situatën, punoi në drejtim të sensibilizimit të punëdhënësve e punëmarrësve, për masat anticovid. Ky vit shënon dhe numrin më të lartë të ankesave apo kërkesave për informim adresuar, e ku cdo rast, është ndjekur, trajtuar, zgjidhur e adresuar në kohë.

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

ISHPSHSH-ja si institucion ekzekutiv duhet të garantojë që veprimtaria inspektuese e inspektorëve të punës do të jetë në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat strategjike të tij:

- ✓ rritja e efektivitetit të inspektimeve të punës,
- ✓ rritja e nivelit të transparencës për procesin e inspektimit,
- ✓ shmangjen e abuzimit me detyrën në shkelje të ligjit nga të dy aktorët e përfshirë në këtë proces, inspektorë pune dhe punëdhënës.

Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij raporti, bazohet në, të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit, identifikimi i problematikave nga analiza e gjetjeve, konsultimi me legjislacionin në raport me zbatimin në praktikë të tij, si dhe zhvillimin e metodologjive, platformave inovative.

1- Të dhënat e inspektimit përfshijnë:

Instrumentat e Fushës së punës realizuar nga 12 Degët Rajonale, ku përfshihen, numrin e inspektimeve të realizuar nga çdo inspektor pune, llojit të inspektimit të kryer, llojit të aktivitetit ekonomik, numrit të aksidenteve në punë, ankesave, informalitetit, punësim kategorish të veçantë punëmarrësish, shkeljeve të dispozitave ligjore, masave administrative, si paralajmërime, pezullime apo sanksioneve të vendosura dhe ndjekjes së tyre.

Instrumentat e Fushës së shërbimeve shoqërore ku përfshihen, të dhëna nga data-base për kapacitetet e qendrave të përkujdesit, pyetësor për menaxherët dhe drejtues të qendrave, pyetësor për punonjësit social dhe intervistat me përfituesit.

2- Identifikimi i problematikave nga analiza e gjetjeve duke parë krahasimisht trendin pozitiv dhe negativ të çështjeve specifike, që reflektojnë nga njëra anë nivelin e zbatimit të legjislacionit të punës nga punëdhënësit në aktivitetet ekonomike të tyre dhe nga ana tjetër ato të standarteve të shërbimeve shoqërore në qendrat e përkujdesjes sociale.

3- Konsultimi me legjislacionin në raport me zbatimin në praktikë të tij, duke identifikuar çështjet apo situata që nuk mbulohen shprehimisht nga ligji apo vetë situata dhe rrethanat e bëjnë të pazbatueshme në praktikë një dispozitë ligjore. Për të dyja konstatimet, evidentim të adresimit të problematikës/ave në autoritetin përgjegjës.

4- Zhvillimin e metodologjive, platformave inovative. Duke evidentuar arsyet, qëllimin dhe çfarë synohet përmes zhvillimit të tyre.

PËRMBLEDHJE

Gjatë Vitit 2020 si një vit i pazakontë, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka punuar në disa drejtime. Është punuar në realizimin e inspektimeve përmes platformës e-inspektimi, realizimin e verifikimeve në drejtim të zbatimit të masave anticovid përmes aplikimit në google forms, si dhe përmes këshillimeve me grupe pune, edhe me institucionet e tjera të qytetarëve në lidhje me zbatimin e masave anticovid.

Me një staf prej 95 inspektorësh në terren janë realizuar inspektime, këshillime e verifikime në 24612 subjekte ekonomike ku:

5993 subjekte të inspektuara përmes e-inspektimi (planifikime, ankesa, aksidente, kerkesa)

18616 subjekte të verifikuara e këshilluara për masat anticovid përmes google forms.

31100 mesatare e qytetarëve të këshilluar e sensibilizuar për respektimin e masave.

Këto të dhëna tregojnë për një angazhim të stafit inspektues, e ku me një mesatare prej 259 inspektime realizuar për inspektor në vit, shifër kjo **1.8 herë më lartë**, se mesatarja e inspektimeve që mund të realizojë trupa inspektuese në kushte normale, nga 13 inspektime në muaj (e dhenë kjo nga inspektimet e vitit 2019), në 23.5 inspektime në muaj realizuar nga një inspektor (gjatë vitit 2020)

Viti 2020 është karakterizuar nga ndjekja e verifikimi i më shumë rasteve se periudha e një viti më parë i denoncime, aksidente, kerkesa, sqarime, të paraqitura sidomos pas shpalljes së pandemisë. Organizimi i punës në këtë periudhë të vështirë, është realizuar përmes:

- a. Adresës zyrtare, apo formave denoncuese zhvilluar në faqen ëeb të institucionit
- b. Numrave të kontaktit të institucionit të publikuara në faqen ëeb
- c. E-maileve e denoncimeve të marra nga zyra e bashkëqeverisjes, sipas kontakteve e personave përgjegjës përcaktuar dhe më parë.
- d. Medias
- e. Organizimit e bashkepunimit me institucionet e tjera si pjesë e grupeve të gatshme “task-force” sipas 12 qarqeve.

Në kuadër të këtij organizimi, në këtë periudhë kanë marrë shërbimin e inspektimit të punës:

177 subjekte më shumë se një vit më parë, për shkak denoncimi të shkeljeve të legjislacionit të punës. Janë gjithsej 777 inspektime me procedurë inspektuese online nga inspektorët e punës, për shkak të denoncimeve.

Numërojmë rreth 2 herë më shumë se një vit më parë, asistim me shërbim inspektues e këshillimi iniciuar me kërkesë të subjektit, falë mundësimin të aplikimeve tashmë online edhe përmes platformës e-albania të kërkesave për:

- ✓ leje punë të biznesit, para fillimit dhe hapjes së një kantieri të ri,
- ✓ leje pune për punësim të miturish,

- ✓ leje për pune të kryer mbi kohen normale të punës në rastet madhore,
- ✓ leje në mbështetje të programit IPARD,

Riorganizimi i burimeve njerëzore.

Në kuadër të përmirësimit në aspektin funksional dhe procedural të saj, përshtatur me kontekstin aktual dhe ligjor të sistemit të inspektimit të punës, tashmë, Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është pjesë e riorganizimi të organikës së vet.

Në kuadër të Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësi 2019–2022 dhe Plani i saj i Veprimit përmbushjes së qëllimit dhe realizimit të objektivave, mirëfunksionim dhe efience e shtuar e trupës inspektuese, tashmë sistemi i inspektimit të punës dhe sigurimi i mbikqyrjes së punës, do të ketë një përmirësimin në kuadër të klimës bashkëpunuese me biznesin, duke zbatuar dhe qenë në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe ligjeve që përcaktojnë procedurat e funksionimit.

Çështjet e marrëdhënieve të punës dhe ato të sigurisë dhe shëndetit në punë, ndëthuren me njëra tjetrën në një proces inspektimi duke patur ndikim të ndërsjelltë tek njëra tjetra duke ju përgjigjur denjësisht fushës së inspektimit të punës. Kryerja e një pune të denjë, fillon nga formalizimi i një marrëdhënie së punë e deri tek kushtet e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, për cdo punëmarrës.

Për të kryer me korrektësi misionin që ka Inspektorati i Punës, puna është orientuar drejt një reforme, që nis me bërjen e një institucioni të njohur dhe me autoritet, të besueshëm, transparent dhe për më tepër të përgjegjshëm.

Vendosja e inspektimit të punës dhe rolit të inspektorit në garantimin dhe rritjen e vazhdueshme të zbatueshmërisë së dispozitave ligjore të parashikuara në legjisllacionin e punës lidhet ngusht me rritjen e efencës së inspektimeve. Funksioni i inspektimit të punës si një sistem eficient, këshillimor në rrallë të parë dhe ndëshkues atje ku është e domosdoshme kërkon sistem planifikimi mbi bazë risku. Krijimi i Sektorit të Analizës së Riskut, do të mundësojë analizën e munguar të riskut për procesin e menaxhimit të risqeve për planifikimin dhe monitorimin e punës inspektuese të terrenit. Ky propozim do të ndikojë drejtpërsëdrejti në rritjen e mbulimit të territorit të RSH me inspektim Pune dhe efektivitetin dhe matjen e tij për cdo inspektim duke konkluduar në përmirësimin e drejtpërdrejtë e me masa konkrete të nivelit të zbatueshmërisë së legjisllacionit të punës.

Viti që lamë pas diktoi më së shumti nevojën e ngritjes së grupeve inspektuese të përbashkëta me inspektor pune jo vetëm të një rajoni të vogël, ku dhe qasja në problematika inspektimi nuk sillte risi në zgjidhje. Tashmë organizimi nga 12 qarqe në 6 drejtori, krijon mundësinë e mirë menaxhimit në stafit si dhe mbulimit të një territori gjeografik me më shumë grupe inspektuese duke shmangur, abuzimet me grupe të njëjta inspektuese. Me zgjerimin gjeografik që mbulon një drejtori, është menduar krijimi i rolit përgjegjes sektori në 12 rajonet pozicione këto lehtësuese për rolin menaxues së kryeinspektorit rajonal, në raportimet e punës.

Funksioni i inspektimit të punës si një sistem eficient, këshillimor në rrallë të parë dhe ndëshkues atje ku është e domosdoshme kërkon sistem planifikimi mbi bazë rrishtu.

Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore.

- ✓ Trajnim për inspektorët e rinj, në lidhje me mjekun e ndërmarrjes, sëmundjet profesionale, Dokumentin e Vlerësimit të Riskut, Këshillin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë etj.
- ✓ Inspektorati i Punës me mbështetjen e ILO-s (Organizata Botërore e Punës) dhe Qendrën Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë ka zhvilluar një cikël trajnimesh për inspektorët e punës dhe përfaqësuesve të partnerëve socialë me tematikë "Mbi veprimet praktike, për parandalimin e përhapjes të COVID-19 në vendet e punës".

Promovimi dhe zbatimi i instrumentave ndërkombëtare kyç të sigurisë dhe shëndetit në punë.

- ✓ Përgatitja e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit, mbi ndryshimet në Ligjin Nr 10237 datë 18.02.2010, "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" (ndryshuar).
- ✓ Pjesëmarrje dhe përgatitja e materialeve në lidhje me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së, nëpërmjet Grupeve të Punës Ndërminstrore për Integrimin Europian, për kapitujt 19 dhe 28.
- ✓ Pjesëmarrje dhe përgatitja e materialeve për Nënkomitetin "Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale" dhe "Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet".(23 Janar 2020).
- ✓ Përgatitja e materialeve në kuadër të realizimit të të gjitha detyrimeve që rrjedhin në zbatim të MSA- së, Kartës Sociale, Konventave të ILO-s të ratifikuara nga Parlamenti Shqiptar dhe Rekomandimeve të BE-së.

RAPORTIME SIPAS DEPARTAMENTEVE

Në vijim një analizë e treguesve statistikorë të inspektimeve të punës (jashtë kuadrit të inspektimeve të përbashketa për shkak të pandemisë)

Shqipëria numëron sot rreth 162 mijë subjekte aktive, objekt i kontrolleve të ISHPSHSH-së. Përgjegjësia institucionale, është që përmes kontrolleve të rrisim nivelin e zbatimit të ligjit në subjektet që operojnë në vend, përmes masave e ndërhyrjeve procedurale e ligjore, për zbatimin e legjislacionit të punës, sa i takon marrëdhëniet të punësimit, kushteve të punës, sigurisë në punë, për vende pune të sigurta e të shëndetshme, e që prekin rreth 1274000 të punësuar (aktiv).

Nga një panoramë e informacionit të INSTAT, 18.2% e subjekteve ekonomike aktive, rreth 29600, janë subjekte juridike (përfshirë këtu sektorin publik shtetëror pjesë e objektivave të institucionit për vitin në vazhdim) me numër të konsiderueshëm punëmarrësish, dhe objekt i vazhdueshëm kontrolli i ISHPSHSH-së, dhe detyrimit të përmirësimit të zbatimit të legjislacionit të punës.


	Subjekte gjithsej	Ne % kundrejt totalit te subjekteve	Subjekte me administratore femra	Subjekte me administratore femra, ne % kundrejt totalit te subjekteve
Gjithsej	162,342		41,209	25.4%
Fermerë	44,473	27.4%	4,646	10.4%
Persona Fizikë	88,310	54.4%	30,540	34.6%
Persona Juridikë	29,559	18.2%	6,023	20.4%
Person Juridik/Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	23,922	80.9%	4,432	18.5%
Person Juridik/Shoqëri Aksionare	791	2.7%	124	15.7%
Person Juridik/Ndërmarrje dhe administrata publike	1,745	5.9%	564	32.3%
Person Juridik/OJF, Org. ndërkombëtare	2,461	8.3%	795	32.3%
Person Juridik/Shoqëri të tjera	640	2.2%	108	16.9%

Duke synuar gjithmonë në zgjerimin e hartës së subjekteve ligjzbatuese, dhe detyrimeve ligjore që rrjellin në një marrëdhënie e shëndoshë punësimi, vazhdimisht është synuar në inspektimin e subjekteve me një numër të konsiderueshëm punëmarrësish, tashmë kemi një rrtje të ndjeshme të kontrolleve në këto subjekte.

Keshtu:

Vite	Subjekte Private dhe Shtetërore			Vetëm Subjekte Private		
	Inspektime	Nr i Punëmarresve	Mesatare e vendeve të punës për subjekt	Inspektime	Nr i Punëmarresve	Mesatare e vendeve të punës për subjekt
Viti 2016	11299	219114	19.4	11235	210320	18.7
Viti 2017	7958	182154	22.9	7923	176744	22.3
Viti 2018	12297	291244	23.6	12222	272296	22.3
Viti 2019	13079	296,808	22.6	13015	282,782	21.7
Viti 2020	5993	168246	28.1	5942	159022	26.7

Duke rritur ndjeshmë numrin e vendeve të punës për subjekt, të cilët marrin shërbimin e inspektimit të punës. (Shih Grafikon1.1)




Ndryshe nga analizat e viteve më parë, këtë vit falë informacionit të detajuar që mundëson tashmë platforma “matrica e denime”, rezultojnë se niveli i zbatimit të legjislacionit të punës nga subjektet ekonomike është në masën 18.8%. Ndërkohë janë 81.2% e subjekteve të inspektuara (jo e numrit të inspektimeve të kryera, pasi brenda viti ka dhe riinspektime) që kanë shkelje të dispozitave ligjore të evidentuara gjatë inspektimit. Numri mesatar i dispozitave ligjore të shkelura për subjekt rezulton më shumë se 2.

Për çdo konstatim të shkeljeve apo mangësive të evidentuara, në zbatim të një dispozite ligjore, grupi i punës përmes vendimit të inspektimit, lë detyra me afate kohore për t’u realizuar, nga ana e subjektit të inspektuar. Në lidhje me shkeljet e dispozitave ligjore flagrante të lidhura drejtpërdrejtë me cënime e sigurisë në vendin e punës, shkeljeve të përsëritura nga ana e subjektit objekt inspektimi, në respect të procedurës inspektuese, janë marrë masat nga këshillim, deri në gjyba administrative.

Konkretisht ky informacion marë nga platforma, flet qartë mbi masat e mara nga grupet inspektues.

	Vendimarrje në % për cdo shkelje, kundrejt totalit të shkeljeve ligjore të evidentuara
12.5%	e shkeljeve të evidentuara, rezultojnë me masën, Këshillim
70.3%	e shkeljeve të evidentuara, rezultojnë me masën, vetëm detyra për realizim
1.2%	e shkeljeve të evidentuara, rezultojnë me masën Pezullim
12.6%	e shkeljeve të evidentuara, rezultojnë me masën, Paralajmërim
3.4%	e shkeljeve të evidentuara, rezultojnë me masën, Gjobë

Këto të dhëna shprehin qartazi misionin e ISHPSHSH-së e të inspektimit të punës ku në rrallë të parë, është këshillimi me qëllim rritjen e nivelit të zbatimit të ligjit, e më pas ndëshkim për shkelësit flagrantë të tij.



Inspektimet e realizuar vetëm nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së, gjatë vitit 2020 ndryshe nga vitet e tjera mbartim një numër më të lartë të inspektimeve të realizuara si çështje jashtë programimi, e konkretisht e krahasuar me një vit më parë janë 798 inspektime të tilla.

Lloji i inspektimit	Viti 2020		Viti 2019	
	Inspektime të realizuara	ne % kundrejt totalit të inspektimeve vjetore të realizuara	Inspektime të realizuara	ne % kundrejt totalit të inspektimeve vjetore të realizuara
Inspektime të programuara	3968	66.2%	10256	78.4%
Inspektime për shkak aksidenti në punë	201	3.4%	197	1.5%
Inspektime për shkak ankese	777	13.0%	600	4.6%
Inspektime rastësore (shkelje flagrante evidente, tashmë edhe masat anticovid)	1047	17.5%	2026	15.5%
Total Inspektime	5993		13079	

Nisur nga situata e krijuar nga COVID-19, në vijim të punës inspektuese për zbatimin e Vendimit nr. 15 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, me qëllim garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, inspektorët e punës kanë vazhduar punën në terren, si pjesë e grupeve task-force udhëhequr nga prefekturat, dhe grupeve udhëhequr nga ISHSH, sipas kërkesave të këtyre të fundit.

Kategoria e Biznesit (Lloji i aktivitetit)	18616 Subjekte
Transport - Taksi	0.1%
Call Center	0.2%
Fasoneri	1.1%
Bankat/Institucionet Financiare	0.9%
Tregtia me pakicë e rrobave të reja në dyqane	5.2%
Njësitë e shërbimit në sportele	4.2%
Markete/supermarkete/ushqimore në ambient të mbyllur	17.9%
Biznes trajtim flokësh/estetikë/trajtim trupor	3.3%
Aktivitete në tregje publike	1.4%
Biznese që nuk janë në kategoritë e mësipërme me deri në 25 të punësuar	16.5%
Biznese që nuk janë në kategoritë e mësipërme me 26-50 të punësuar	0.4%
Biznese që nuk janë në kategoritë e mësipërme me mbi 50 të punësuar	0.4%
Klinikat Dentare	1.6%
Aktivitetet Ndertuese	2.1%
Bar-Kafe-Restorante	33.1%
Shkolla Kopështe dhe cerdhe	1.4%
Qendrat Tregtare	0.01%

Nga inspektimet në kuadër të derregullimit në këto muaj të realizura me njoftim paraprak për të cilat subjektet nuk harxhojnë më kohë fizike dhe dokumentacion të sjellë pranë zyrave të Inspektoratit, duke bërë kërkesë në e-albania, e-mail ose postë dhe më pas shkohet me inspektim, për këto 3 shërbime janë:

- ✓ 31 janë realizuar pas kërkesës së subjektit për autorizim për miratim leje pune
- ✓ 9 janë realizuar për aprovim autorizimi për të punuar në orë shtesë nga të cilët 4 janë autorizuar,
- ✓ 19 janë autorizim për të mitur ku janë autorizuar 16 fëmijë.

Gjithashtu këtë 12 muaj, janë realizuar 775 inspektime mbi aplikuesit e programit IPARD II 2014-2020. Për aplikuesit pas procedurës së inspektimit u është dorëzuar dhe certifikata që vërteton përpunueshmërinë e subjektit me standartet e BE-së për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas parashikimeve në legjislacionin e BE-së dhe atë shqiptar në lidhje me investimin

dhe me standaret e sigurisë në punë, bazuar në inspektimin e kryer nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në objekt.

Disa nga treguesit e përgjithshëm statistikorë të inspektimeve realizuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, vetëm përmes sistemit e-inspektimi, dhe jo inspektime të përbashkëta me institucionet e tjera kontrolluese, nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së janë:

	Viti 2019	Viti 2020
Numri i Subjekteve të inspektuara Private + Shtetërore	13079	5993
Vende pune të inspektuara	296808	168246
Numri i Punëmarrëseve femra	147542	89217
Mesatare e punëmarrës për subjekt	22.6	28
Numri i Subjekteve private të inspektuara	13015	5942
Vende pune të inspektuara në subjektet private	282782	159.022
Numri i Punëmarrëseve femra	142239	11.468
Mesatare e punëmarrës për subjekt në subjekte private	21.7	26.7
Numri i Punëmarrësve pa kontrata individuale të evidentuar	4358	1409
Numri i Punëmarrëseve femra pa kontrata individuale	1706	439
Numri i Punëmarrësve informal të evidentuar	2879	1221
Numri i Punëmarrësve informale femra të evidentuar	994	368
Numri i Punëmarrësve informal të futur në skemën e SSH	2794	1163
Numri i Punëmarrësve informale femra të futur në skemën e SSH	970	345
Numri i Punëmarrësve nën 18 vjeç të evidentuar	225	158
Numri i Punëmarrëseve femra nën 18 vjeç të evidentuara	88	77
Numri i Punëmarrësve të huaj të evidentuar	1106	290
Numri i Punëmarrësve të huaj, pa leje pune	18	12
Numri i Punëmarrësve me aftësi të kufizuar	195	203
Numri i Punëmarrëseve femra me aftësi të kufizuar	59	24
Numri i Subjekteve ku për për shkelje të dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës janë mbajtur masa administrative “Pezullim”	1568	669
Numri i Subjekteve ku për shkelje të dispozitave ligjore të sigurisë e shëndetit në punë janë mbajtur masa masë administrative “Pezullim”	151	171
Numri i Subjekteve ku për shkelje të dispozitave ligjore janë mbajtur masa administrative “Paralajmërim”	1692	700
Numri i Subjekteve ku për shkelje të dispozitave ligjore janë mbajtur masa administrative Gjobë”	160	85
Vlera totale e sanksioneve (lekë)	38162.2000	19.922.000
Numri i Inspektimeve të programuara	10256	3968
Numri i Inspektimeve për shkak Ankese	600	777
Numri i Inspektimeve rastësore	2026	1047
Numri i Inspektimeve për shkak Aksidenti	197	201
Numri i Punëmarrës të aksidentuar	176	182
Numri i Punëmarrëse femra të aksidentuara	24	24
Numri i Punëmarrës të aksidentuar me vdekje	38	36
Numri i Punëmarrëse femra të aksidentuar me vdekje	0	2

Konstatime:


	Viti 2019	Viti 2020
Mesatare e punëmarrës për subjekt	22.6	28.0
Konstatim i punesimit pa kontrata pune	0.8%	1.5%
Konstatim i punesimit informal	1.0%	0.7%
Punesimi informal i formalizuar brenda procesit inspektues	97.0%	95.2%
Konstatim i punësimit të të huajve pa leje pune	1.6%	4.1%

Punësimi informal (subjekte private të inspektuara):

Një ndër indikatorët e matshëm në fushën e inspektimit ngelet informaliteti. Ashtu si detyra dhe misioni i çdo inspektori ngelet udhëheqja nga kërkesat e përcaktuara në politikën e zbatimit të inspektimit, për të gjitha rregullat dhe objektivat në mënyrë të njëtrajtshme, të barabartë dhe transparente ndaj të drejtave të punëmarrësve që respektojnë ligjin. Duke krijuar një praktikë të mirë inspektimi që do të thotë krijimi i një mjedisi pune të mirë, produktive, të sigurt në respekt të normave të së drejtës që të jep ligji. Në mbështetje të ligjit 9634/2006, “Punësimi informal” është përcaktuar si një marrëdhënie punësimi që nuk u nënshtrohet nga ana ligjore, ashtu edhe në praktikë kërkesave të legjislacionit të punës dhe ligjit për procedurat tatimore dhe ku punëmarrësi nuk përfiton të drejtat e tij që burojnë nga këto ligje. Më poshtë referojmë indikatorët e matshëm të punëmarrësve informal në inspektimet e programuara dhe në inspektimet e kryera jashtë programit.

Nr.	Indikatorë Inforamiliteti	Viti 2020
A	Numri i punëmarrësve gjithsej të pasiguruar të konstatuar gjatë procesit të inspektimit	1221
A1.1	Numri i punëmarrësve gjithsej të futur në Skemën e Sigurimeve Shoqërore dhe shëndetësore gjatë procesit të inspektimit	1163
A2.1	Numri i punëmarrësve informal për të cilët nuk është marrë masë urgjente dhe janë raportuar në Drejtorinë e Tatimeve	58
A3.1	Numri i punëmarrësve informal në inspektime të programuara	281
B	Punësimi informal në inspektime jashtë programit	940
B2.1	Numri i punëmarrësve informal të konstatuar në inspektime të kryera për shkak aksidenti	8
B2.2	Numri i punëmarrësve informal të konstatuar në inspektime të kryera për shkak ankese	134
B2.3	Numri i punëmarrësve informal të konstatuar në inspektime rastësore	798

Të dhëna mbi informalitetin e konstatuar në vite edhe pse ky vit u karakterizua me një numër të ulët inspektimesh për shkak të pandemisë rezulton:



Treguesit informal sipas degëve sipas llojit të inspektimit

Degët Rajonale	informal në inspektime <u>rastësore</u>	informal në inspektim <u>ankese</u>	informal në inspektim <u>aksidenti</u>	Informal në Inspektime të <u>programuara</u>
Berat	-	1	-	1
Dibër	7	-	2	5
Durrës	85	33	2	34
Elbasan	69	3	2	16
Fier	9	-	-	-
Gjirokastrë	10	2	-	8
Korçë	99	-	-	28
Kukës	93	-	-	26
Lezhë	40	-	-	7
Shkodër	117	-	-	11
Tiranë	207	72	2	117
Vlorë	62	23	-	28
Total	798	134	8	281
Ne % kundrejt totalit te punësimit informal te evidentuar	65.4%	11.0%	0.7%	23.0%

Shihet qartë që inspektimet e hapara si ceshtje rastësore që nenkupton ceshtje për shkelje flagrante, mbrat dhe numrin më të lartë të punësimit informal të evidentuar. Por dhe një mirë programim inspektimi, krahasimisht me vitet e tjera jep rezultat në evidentimin e shkeljeve të dispozitave ligjore për marrëdhënie punësimi dhe rrjedhimisht ndërhyrjet për formalizim të tyre.

Mundësuar tashmë dhe nga platforma “Matrica e Dënimeve”, të dhënat e inspektimeve flasin për:

Mesatare e fuqisë punëtore për një subjekt	28.0
Punemarres <u>me kohe te plote</u>	96.3%
Punemarres <u>me kohe te pjesshme</u>	1.2%
Punemarres <u>qe kryejne punen ne shtepi</u>	1.0%
Numri i punemarresve <u>informal gri</u> te konstatuar (mangësi në marrëdhënie punësimi konform legjislacionit)	1.4%
Numri i punemarresve <u>gri te formalizuar</u> gjate inspektimit	48.7%
Numri i Subjekteve që kryejnë punë <u>mbi kohën normale të punës</u>	1.8%
Numri i <u>punëmarrësve</u> që kryejnë pune <u>mbi kohën normale</u>	2.2%
Numri i punëmarrësve që <u>nuk paguhen për orët e punuar mbi kohën normale të punës</u>	54.5%
Numri i punëmarrësve që <u>nuk paguhen për orët e punuara në turne</u>	27.3%
Numri i punëmarrësve qe <u>nuk paguhen për orët e punuar ditët e pushimeve javore apo festave</u>	31.3%
Numri i punëmarrësve që paguhen me page, <u>nën pagën minimale</u>	1.1%
Nr.i punëmarrësve,të siguruar me <u>pagë minimale</u>	35.0%
Ekzistence sindikate/kontrate kolektive	0.6%

Ankesat, kerkesat dhe informacion sqarues mbi detyrimet ligjore

Viti 2020 ishte dhe viti me një numër të shtuar të inspektimeve për shkak ankese, trajtuar nga trupa inspektuese.

Kështu janë 1060 ankesa e kërkesa për sqarim adresuar pranë institucionit, numër 2 herë më i lartë se një vit më parë.

Rastet e adresimeve në shifra flasin për:

10.5% e rateve me problematikë “mjekun e punë”

24.6% e rasteve me problematikë “vonesa në page e contribute”

3.5% e rasteve me problematikë “mospagesë raporti paaftësie.

38.6% e rasteve me problematikë “cënimi i marrëdhënieve të punësimit”

22.8% e rasteve me problematike “komunikime për sqarime ligjore”


61% e ankesave janë zgjidhur në favor të punëmarrësve plotësisht ose pjesërisht.

Pjesa tjetër e tyre si çështje jo të zgjidhura, lidhet me një sërë faktorësh ku më kryesorët përmendim:

- ✓ Subjekti ndaj të cilit është adresuar ankesa nuk ushtron aktivitet,
- ✓ Disa pretendime të ankesës tejkalojnë kompetecën e inspektorit të punës për zgjidhje,

- ✓ Nuk gjenden të justifikuara pretendimet e ngritura pas verifikimit të kryer nga inspektori etj.

Numrin më i lartë i ankesave të drejtuara rezultojnë nga punëmarrës që punojnë në subjektet ekonomike të degës Tiranë, kjo edhe për faktin e përqendrimit të lartë të bizneseve në këtë hapësirë gjeografike.



Aksidentet në punë dhe për shkak të saj

Gjatë vitit 2020 janë regjistruar dhe ka përfunduar hetimi administrativ, për **168 raste të aksidentit në punë**. Për efekt hetimi të detajuar të këtyre aksidenteve gjatë vitit rezultojnë 201 inspektive të iniciuara për këtë shkak.

Gjatë hetimeve, janë konfirmuar **182 punëmarrës** të aksidentuar në punë, prej të cilëve **36 punëmarrës rezultuan me pasojë fatale**.

Në 77 % të punëmarrësve të aksidentuar, shkaqet lidhen drejtpërdrejtë me kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë, ndërkohë që 72% e aksidenteve me pasojë fatale për jetën kanë ndodhur për këto shkaqe.

		VITI 2020	
		<i>Punëmarrës të aksidentuar</i>	<i>Punëmarrës të aksidentuar, me pasojë fatale</i>
	AKSIDENTE	182	36
1	Aksidente që lidhen direkt me punën	140 (77%)	26 (72%)
2	Aksidente rrugore	24	5
3	Aksidente për shkaqe të tjera, të palidhura drejtpërdrejtë me punën	18	3

1.1	Aksidente që lidhen direkt me punën (pa aktivitet minerare)	112	21
1.1.1	Aksidente në aktivitete minerare	28 (20%)	5 (19%)

Nisur nga shkaku i ndodhjes, 23% e punëmarrësve të aksidentuar në punë janë aksidentuar për shkaqe të ndryshme nga ato të kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë. Rastet e aksidenteve në miniera, nuk janë në kontrollin e drejtpërdrejtë të inspektorit të punës. Këto subjekte janë objekt kontrolli nga ana e ISHPSHSH-së, ku inspektori i punës konfirmon rastet e aksidenteve të ndodhura në punë, por verifikimi i kushteve të sigurisë dhe shëndetit në nëntokë, kryhet nga AKSEM (Autoriteti Kombëtar i Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera), i cili përcakton edhe shkakun e ndodhjes së ngjarjes dhe rregullat e shkelura.

Bazuar në ligjin nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” vlerësohen si aksidente në punë edhe rastet kur aksidenti ka ndodhur rrugës në linjën e drejtpërdrejtë nga banesa për në punë dhe anasjelltas, si në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësi ashtu edhe individualisht nga punëmarrësi, si edhe rastet kur gjatë kryerjes së punës janë goditur nga një automjet. Gjatë këtij viti rezultojnë 24 raste aksidenti rugorë sipas këtij koncepti të ligjit e të hetuara nga ISHPSHSH-ja, 5 prej të cilëve kanë rezultuar me pasojë të humbjes së jetës.

Në grupimin “Raste të aksidenteve për shkaqe të tjera, të palidhura drejtpërdrejt me punën” janë shënuar rastet të tilla si:

- ✓ Gjendja shëndetësore e punëmarrësit, jo sëmundje e përgjithshme, ku gjatë orarit të punës ka pësuar infarkt që ka sjellë humbje të menjëhershme të jetës.
- ✓ Kushteve atmosferikë të kohës, ngricat, debora apo pengesat në rrugë kanë sjellë që punëmarrësit të rrëshkasin gjatë kryerjes së punës.
- ✓ Aksident i ndodhur jashtë territorit të RSH dhe hetimi është kryer nga inspektorët e Republikës së Kosovës.

Nga hetimi i këtyre aksidenteve rezultoi se:

- ✓ Moshë mesatare e punëmarrësve të aksidentuar ishte 42 vjeç.
- ✓ Numri i punëmarrësve femra të aksidentuara ishte 25 që zënë 13.7% të punëmarrësve të aksidentuar.
- ✓ Aksidentet kanë ndodhur më shpesh gjatë ditës së mërkurë (rreth 50 raste), duke u pasuar nga dita e martë.
- ✓ Në 68% të rasteve, punëmarrësit janë aksidentuar në 0 - 5 orë pasi kanë filluar punën.

Janë 33 raste të aksidenteve me pasojë vdekje, ku në 2 raste aksidentet kanë qenë masive (2 dhe 3 punëmarrës të aksidentuar njëkohësisht dhe për të njëjtin shkak). Konkretisht në 1 rast me 2 punëmarrës më pasojë vdekje është aksident rrugor, dhe rasti tjetër me 3 punëmarrës të asfiksuar nga gazi i mërkurit në nëntokë, në një subjekt me aktivitet “miniera kariera”.

Aksidentet me pasojë vdekje sipas Degeve Rajonale, kanë ndodhur në 33% të tyre në Tiranë, në 19% në Dibër, në 14 % në Durrës.

Numri më i lartë i punëmarrësve të aksidentuar me pasoja fatale janë në sektorin e ndërtimit, në masën 27%. Në “Ndërmarrjet prodhuese” janë 22% e rasteve me pasoja fatale ndërkohë që 14% e punëmarrësve me pasoja fatale rezultojnë në subjektet minierare.

Numër i konsiderueshë i punëmarrësve të aksidentuar janë dhe rastet e subjekteve shtetërore ku numërohen 29 punëmarrës të aksidentuar nga të cilët 7 punëmarrës kanë rezultuar me pasoja fatale.

Nisur nga shkakut i aksidententeve me pasojë vdekje:

- ✓ 28% e tyre kanë si shkak të aksidentit “*rënien nga lartësia*”;
- ✓ 12% moszbatim i rregullores së *sigurimit teknik*;
- ✓ 9% rënia kontakt me *energjinë elektrike*;
- ✓ 14% aksidente *rrugore* me pasojë vdekje.

Në 14 raste inspektimi për shkak aksidenti në punë, kanë qenë raste për herë të parë, në këto aksidente me pasoja fatale.

4 nga punëmarrësit e aksidentuar me shkak vdekje kanë rezultuar punëmarrës të padeklaruar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shendetësore. Gjithashtu kanë qenë pa kontratë individuale apo kolektive të nënshkruar.

2 nga aksidentet me pasojë vdekje nuk janë njoftuar në kohë nga subjektet, apo njoftimi nga ana e tyre ka munguar.

Janë 2 punëmarrëse femra të aksidentuara me pasojë vdekje, si shkak i aksidenteve rrugore.

Të aksidentuarit me pasojë vdekje janë me shtetësi shqiptare, dhe kryesisht me pozicion pune punëtor, vagonist, vinciër, specialist ndërtimi, shofer etj.

36% e punëmarrësve me pasojë vdekje, aksidenti ka ndodhur 1 ditë deri në 1 vit nga fillimi i punës me punëdhënësin aktual, që do të thotë në punën aktuale.

Në 60 % të inspektivëve me pasojë vdekje të punëmarrësve, inspektorët e punës kanë bashkëpunuar për hetimin administrativ të rastit me organet e Policisë apo/dhe Prokurorisë; me Autoritetin Kombëtar të Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera; me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial; Spitalin dhe Institutin e Mjeksisë Ligjore.

77% e subjekteve ku kanë ndodhur aksidentet në punë me pasojë vdekje janë sanksionuar me dënim administrativ kryesor, ndërsa rastet për të cilat nuk është vendosur sanksion janë ato që nuk lidhen drejtpërdrejtë me punën. Në cdo rast janë shoqëruar me detyra për realizim.

Në bazë të detyrave të lëna që përkojnë me gjetjet e konstatuara si shkelje, janë evidentuar:

- ✓ mungesë të një vlerësimi të risqeve,
- ✓ mospërdorim i pajisjeve mbrojtëse individuale,
- ✓ moszbatimi i rregullave të sigurimit teknik,
- ✓ mungesa e pajisjeve mbrojtëse individuale,

- ✓ mungesa e informimit të punëmarrësve.

Janë regjistruar **10 raste të aksidenteve masive**, ku kanë mbetur të lënduar 24 punëmarrës, nga të cilët 7 me pasojë humbje jete. 13% e punëmarrësve të aksidentuar janë pjesë e aksidenteve masive. Vlen të theksohet se 4 nga këto raste me 10 punëmarrës të aksidentuar, janë aksidente rrugore dhe 3 raste, me 7 punëmarrës të aksidentuar, nga të cilët 4 me vdekje kanë ndodhur në miniera.

Aksidentet masive janë regjistruar kryesisht nga Degët Rajonale të ISHPSHSH-së Dibër, Elbasan, Berat, Lezhë, Shkodër.

Rastet e aksidenteve masive përbërjé kështu 6 % të rasteve të aksidenteve të ndodhura në total në vitin 2020.

Aksidentet e përsëritura në të njëtin subjekt

8 subjekte janë prekur nga aksidentet në punë më shumë se 1 herë gjatë vitit 2020.

Vlen të theksohet që rastet e aksidenteve të përsëritura janë kryesisht në subjekte minerare, si psh në “Albchrome” (13 raste të aksidenteve); “Tete Albania&Mining” 2 raste, si dhe aksidente të shënuara në subjektin “OSHEE” në degë të ndryshe të saj.

Ka edhe rast të aksidenteve të përsëritura në të njëtin subjekt, që klasifikohen si aksidente rrugore. Edhe në subjektet shtetërore, janë regjistruar raste të aksidenteve të përsëritura.

Kështu në total rastet e aksidenteve të përsëritura përbëjnë 4.7% të subjekteve me raste aksidenti.

Lloji I aktivitetit	Te aksidentuar total	Te aksidentuar femra	Te aksidentuar me vdekje	Te aksidentuar me vdekje femra
Bujqesi pyje peshkim	2	-	-	-
Miniera kariera	28	3	5	-
Ndermarrje prodhuese	47	7	8	-
Elektricitet gaz uje	12	-	1	-
Tregeti H-B-R	10	2	1	-
Ndertim	39	-	10	-
Transport	4	-	1	-
Finance sherbime	3	-	1	-
Te tjera	37	12	9	2
Total	182	24	36	2

- ✓ 24 nga punëmarrësit e aksidentuar janë **femra**, 2 nga të cilat me pasojë fatale për jetën, me shtetësi shqiptare. Për 67% të punëmarrësve femra të aksidentuara pasojat e aksidentit janë të lehta (mbi tre ditë raport paaftësie për punë). Moshë mesatare e femrave të aksidentuara është 44
- ✓ Ka pasur 1 rast të **fëmijëve nën 18 vjeç** të aksidentuar gjatë punës, me pasojë të lehta.

- ✓ Nuk ka pasur persona *me aftësi të kufizuar* të aksidentuar gjatë punës.
- ✓ Punëmarrës *të huaj*

Drejtoritë Rajonale të ISHP-së me numrin të madh të aksidenteve rezultojnë Tirana, Durrës, Dibra, Korçë. Kjo mund të jetë e lidhur edhe me:

- ✓ Kanë edhe përqëndrimin më të madh të numrit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet.
- ✓ Dibra, pasi aksidentet kryesisht janë rregjistruar në minierën e Bulqizës dhe në pjesën më të madhe të rasteve në subjektin Albchrome.
- ✓ Detyrimi për të raportuar aksidentet në punë pranë ISHPSHSH-së, në këto degë është më i njohur nga subjektet që operojnë në këtë zonë, duke treguar për një nivel më të lartë ndërgjegjësimit për raportim të rasteve.

Aksidentet e përsëritura në të njëjtin subjekt ndër vite janë në ulje. Kështu:

Për vitin **2020** aksidentet e përsëritura përbëjnë 5.7 % të rasteve të ndodhura

Për vitin **2019** aksidentet e përsëritura përbëjnë 7.8 % të rasteve të ndodhura.

Për vitin **2018** aksidentet e përsëritura përbëjnë 7.2% të rasteve

Në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë inspektimeve të realizuara për këtë vit kemi:

- ✓ në 2700 subjekte ekziston dokumenti i vlerësimit të rrezikut, në 1464 subjekte nuk ekziston ky dokument dhe në 106 subjekte është i pjesshëm.
- ✓ në 932 subjekte ekzistojnë Këshillat e SSHP, në 113 subjekte rezultojnë se këto këshilla dhe pse janë ngritur nuk janë funksional dhe në 2672 subjekte nuk ekzistojnë KSSHP-të
- ✓ në 843 subjekte ekzistojnë përfaqësuesit e Këshillit të SSHP, në 4041 subjekte nuk ekzistojnë përfaqësuesit e KSSHP-ve.
- ✓ në 632 subjekte ekziston koordinatori për SSHP kur subjekti punon me nënkontraktorë,
- ✓ në 3550 subjekte ekziston shërbimi i ndihmës së parë, ku numri i punëmarrësve të çertifikuar në këtë drejtim është 778.
- ✓ në 3813 subjekte ekzistojnë masat mbrojtëse kolektive, në 163 subjekte këto masa janë të pamjaftueshme dhe në 437 subjekte nuk ekzistojnë masat mbrojtëse kolektive
- ✓ Numri i subjekteve ku përdoren masat mbrojtëse individuale është 4136, numri i subjekteve të cilat nuk përdorin paisje mbrojtëse individuale është 293 dhe numri i subjekteve ku këto paisje janë të pamjaftueshme është 73.
- ✓ Numri i punëmarrësve që punojnë me substanca të rrezikshme është 2551
- ✓ Numri i punëmarrësve të diagnostikuar me sëmundje profesionale është 18
- ✓ Numri i mjekëve për periudhën Janar-Dhjetor 2020 është 1821 mjekë, ku 165 mjekë janë me kohë të plotë dhe 1656 mjekë me kohë të pjeshme, ndërsa kontrolli periodik i punëmarrësve ekziston në 3314 subjekte, ku numri i punëmarrësve me kontroll mjekësor periodik është 36583.

Gjithashtu në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së COVID-19 në ambientet e punës, bazuar në Urdhërin nr.266 date 21.04.2020 të Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik dhe protokolleve të përcaktuara nga ky i fundit, sipas përcaktimit në protokollin e kuq, të gjitha subjektet të cilat përfshihen në këtë protokoll duhet të deklarojnë pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore gjeneralitetet dhe licensën e personit përgjegjës për shëndetin në punë (mjekut të ndermarrjes), ku deri më tani kanë deklaruar këto të dhëna pranë Institucionit tonë **371 subjekte**.

Inspektimi i qendrave të përkujdesit shoqëror për plotësimin e Standarteve të Përkujdesit, zhvillimet pozitive dhe problematikat.

Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, pranë ISHPSHSH, është një strukturë shtojcë, që i është bashkëngjitur Inspektoriatit të Punës që nga viti 2012.

Në Dhjetor 2016, ka hyrë në fuqi Ligji Nr.121/2016, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Në Nenin 34, ky ligj, e përcakton Inspektoriatin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror si personi juridik publik buxhetor, pra një strukturë më vete në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, si dhe përcakton mënyrën e funksionimit, përgjegjësitë, kompetencat e këtij institucioni.

Edhe pse kanë kaluar 5 vjet nga hyrja në fuqi të këtij ligji, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, me përgjegjësi dhe kompetencë për inspektimin e standarteve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, vazhdon të jetë në nivel drejtorie, pranë ISHPSHSH, e përbërë nga 1 drejtor dhe 4 inspektorë.

Me miratimin e VKM Nr. 508 datë 13.09.2017 “Për Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, politikat, administrimi, licënsimi, inspektimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror është përgjegjësi e MSHMS, dhe jo më e MMSR-së. Ky kalim i përgjegjësisë së fushës së kujdesit shoqëror në një ministri tjetër tjetër, nuk është reflektuar në të gjitha strukturat në varësi të ish-MMSR-së. Kështu inspektimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, mbeti detyrë e Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, pjesë e ISPSHSH, në varësi të MFE, e cila ka fushë përgjegjësie inspektimin e punës dhe jo të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ndërsa marrëdhënjet e Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore me MSHMS, si ministria përgjegjëse e kujdesit social, kanë ngelur thjeshtë raportuese, dhe shpesh herë të njëanëshme, gjë që ka vështirësuar rolin e kësaj Drejtorie, (inspektimit të shërbimeve të kujdesit social), si një nga aktorët më të rëndësishëm të reformës sociale.

Bazuar në të dhënave që Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore disponon, informacioni i së cilës, përditësohet nga inspektimet e kryera, evidentohen të ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror një numër prej 375 subjekte publike dhe jopublike, (104 shërbime rezidenciale, 100 qendra ditore, 21 qendra multidisiplinare me 38 njësi shërbimi, 86 shërbime komunitare dhe 64 projekte/shoqata në komunitet, për forcim kapacitetesh, lobim, atvokasi, përfaqësim etj.).

Prioritetet dhe treguesit e synuar për vitin 2020

Nr.	Prioriteti	Treguesi i synuar
1	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror , garantimi i respektimit të standarteve të shërbimeve, më qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna, abuzimi, duke vlerësuar si prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si edhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimimit.	Inspektimi i 110 qendrave publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror
2	Njohja dhe respektimi i standarteve të shërbimeve, rritja e kujdesit, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve komunitare, në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit, nëpërmjet inspektimit të qendrave të krijuara nga bashkitë në kuadër të rolit dhe të përgjegjësisë të marra nga bashkitë me Ligjin Nr.121/2016, dhe në zbatim të VKM Nr.518, datë 04.09.2018.	Takime informuese dhe vlerësuese në Drejtorinë e Përkujdesit Shoqëror në 8 bashki
3	Forcimi kapaciteteve inspektuese në bashkëpunimi me organizatat, institucionet ndërkombëtare.	Bashkëpunim me UNICEF

Përgjatë vitit 2020, inspektime, në vend, në qendrat e përkujdesit shoqëror u realizuan deri në Mars 2020, për shkak të urdhëresave të MSHMS-së, për karantinim dhe distancim, (*Urdhërin Nr.157, datë 10.03.2020*), për efekt të marrjes së masave për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Kështu, deri në 10 Mars 2020, u inspektuan 26 qendra të përkujdesit shoqëror, nga të cilat 7 qendra të përkujdesit rezidencial dhe 19 të përkujdesit komunitar. Në këto qendra përkujdesi përfitojnë shërbime 1326 fëmijë, PAK, të moshuar, viktimat e dhunës në familje, individë apo familje në situatë emergjence, etj.

Në 4 nga 26 qendrat e inspektuara, që të katërta shërbime jopublike, u konstatuan plotësim shumë i mirë i kërkesave dhe treguesve të standarteve të përkujdesit shoqëror. Në qendrat e tjera, (22), u konstatuan shërbime me tregues të plotësuar si edhe u dhanë rekomandime me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Realizimi i treguesve numerikë për periudhën Janar – Dhjetor 2020

Nr.	Aktiviteti	Targeti Vjetor	Planet mujore	Fakt	Mosrealizimi	
					Nr.	Arsyeja
1	Takime me strukturat e bashkisë dhe vlerësimi i situatës së përgjithshme të shërbimeve të reja.	8	24	25		
2	Identifikimi dhe vlerësimi i shërbimeve të reja.	-	X	24		
3	Inspektimi i Qendrave të përkujdesit shoqëror	110	29	26	3	Covid 19
4	Intervista on-line për monitorimin e situatës, në qendrat e përkujdesit shoqëror, përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19.	-	-	121		
5	Trajtim ankesash (<i>Portali Bashkëqeverisjes</i>)	-	-	2		
6	Vlerësimi i shërbimeve në procedurë liçensimi	-	-	1		

Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore me qëllim monitorimin e situatës së shërbimit të kujdesit shoqëror, si edhe informimin, këshillimin e vetë qendrave, në kushtet e situatës epidemiologjike realizoi 121 intervista on-line për monitorimin e situatës, në qendrat e përkujdesit shoqëror, nga të cilat 86 intervista me shërbime të përkujdesit rezidencial dhe 35 me shërbime të kujdesit komunitar.

Nga monitorimet e kryera për qendrat e përkujdesit rezidencial nuk raportohen raste të humbjes së jetëve nga Covid 19 të përfituesve të shërbimit, por edhe të stafit përkujdesës. Në të gjitha

qendrat raportohet të jenë marrë masat për funksionimin normal të jetës së brendshme. Në Qendrat e publike, ndryshe nga periudha Mars-Qershor, në muajin Korrik, stafi i shërbimit është kthyer në punë, i gjithë, dhe me turne normale, por Qendrat vazhdojnë ende të funksionojnë vetëm me jetë të brendshme, pa vizita dhe pa dalje jashtë qendrës të përfituesve të shërbimit. Kontaktet e nevojshme mundësohen nga stafi me telefon. Nuk raportohen raste të mohimit të shërbimit apo të shkeljeve ligjore.

Qendrat e përkujdesit komunitar, nuk kanë ofruar shërbim në qendër, por kanë adaptuar programin dhe paketën e mbështetjes në distancë. Kështu, konstatohet që këto qendra kanë ofruar këshillimit psikologjik, paketa me ndihma humanitare. Gjithashtu, qendrat kanë ofruar vaktin ushqimor, i cili është shpërndarë i ambalazhuar, për t'u konsumuar në banesë. Në muajin Korrik ka filluar frekuentimi i qendrave, kryesisht për fëmijë, me grupe jo më shumë se 5 vetë. Për këta fëmijë, jo për çdo ditë, qendrat kanë ofruar, në ambjentet e jashtme, aktivitete/lojra psiko-sociale, ndërkohë që ka vazhduar edhe mbështetja në familje.

Gjatë vitit 2020, pranë Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore **u deleguan 2 ankesa**, që të dyja nga Portali i Bashkëqeverisjes. Ankesat u trajtuan menjëherë, duke inspektuar në vend qendrat e përkujdesit rezidencial, për të cilat kishte ankimim dhe u kthyen përgjigjet përkatëse, përfshirë këtu edhe MSHMS apo institucione të tjera që kishin lidhje me problemin.

Në njërin nga rastet e ankimuar, përtej pretendimit të ankuesit, u konstatua që mungesa e Punonjësit Social dhe dokumentimit të aspekteve të kujdesit social në dosjen personale të përfituesit, duke cënuar cilësinë e shërbimit dhe përmbushjen e Standarteve të Shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për të moshuar në qendrat e përkujdesit rezidencial, (VKM Nr.821, datë 06.12.2006). **Ndaj Qendrës së Përkujdesit Rezidencial u paralajmërua për pezullimin e licencës “Për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit rezidencial” në rast se nuk merren masa për plotësimin dhe dokumentimin e aspekteve të kujdesit social, si detyrim, parashikuar nga Ligji Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, Neni 49, Pika 2, gërma “a”.**

Departamenti Juridik

Sektori Juridik është pjesë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe pjesë themelore të punës ka dhenien e asistencës juridike për gjithë veprimtarinë e institucionit me qëllim zbatimin e drejtë të kuadrit ligjor në fuqi.

Gjatë vitit 2020, sektori Juridik ka monitoruar procesin e inspektimit lidhur me aplikimin e dënimeve administrative, ka dhënë mendim juridik e mbështetje ligjore sa herë është kërkuar nga strukturat institucionale dhe ndërinstitucionale lidhur me, plotësimin dhe përdorimin e dispozitave ligjore për procedurat inspektuese, ashtu edhe me përpilimin, përditësimin e dosjeve gjyqësore për proceset gjyqësore ku institucioni është palë ndërgjyqëse si dhe ndjekjen e gjithë proceseve gjyqësore. Ka dhënë përgjigje në trajtimin e problematikave të ndryshme që paraqesin subjektet shtetërore dhe private si dhe individë të ndryshëm, qoftë në formë shkresore, me email apo edhe duke i sqaruar verbalisht për çështje që kanë të bëjnë me rregullimin e marrëdhënieve të punës dhe zbatimin e Legjislacionit të Punës.

Ky sektor gjatë vitit 2020 ka ndjekur 27 procese gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me sanksionet e vendosura nga inspektimet e kryera në subjekte të ndryshme si dhe marrëdhëniet e punës, nga të cilat janë fituar 17 procese gjyqësore, 7 procese janë humbur dhe pjesa tjetër janë në vazhdim.

Nënvizojmë se gjykatat janë institucione të pavarura që rregullohen e funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe me ligj të vecantë. Vetë legjislacioni e parashikon ankimin në gjykatë si mjetin në shkallë më të lartë hierarkie pas procedurës administrative që kryejnë organet e administratës.

Numri i subjekteve të gjobitura sipas rajoneve:

<i>Deget Rajonale</i>	Subjekte me Gjoba 2020	Arketime të gjobave të vendosura 2020	Arketime gjithsej
<i>Berat</i>	2	1	1
<i>Dibër</i>	4	-	-
<i>Durrës</i>	7	1	11
<i>Elbasan</i>	8	1	2
<i>Fier</i>	-	-	3
<i>Gjirokastrë</i>	3	1	3
<i>Korçë</i>	9	5	11
<i>Kukës</i>	3	-	5
<i>Lezhë</i>	4	2	4
<i>Shkodër</i>	5	2	3
<i>Tiranë</i>	35	16	37
<i>Vlorë</i>	5	2	4
Total	85	31	84

Janë ankimuar dhe shqyrtuar në Komisionin e Ankimit të Gjobave, gjatë vitit 2020, 43 raste, për të cilat në:

- 3 raste është marrë vendimi për ulje të vlerës,
- 5 raste vendimet janë shfuqizuar
- 9 raste është marrë masa për ndryshim nga gjobë në paralajmerim
- 26 raste janë lënë në fuqi vendimet përfundimtare nga grupet inspektuese.

Për ato vendime për të cilat Komisioni i Ankimit të Gjobave, ka vendosur shfuqizim, u është derguar rast pas rasti tërheqje vëmendje inspektorëve që kanë trajtuar këto praktika inspektuese, për zbatimin në mënyrë sa më rigorozë të Legjislacionit të Punës.

Me kërkesë nga Deget Rajonale, janë përgatitur vertetime lidhur me ankimin e subjekteve të sanksionuara nga inspektorët e punës dhe vendimet e KAGJ-së, me qëllim paraqitjen e tyre për nxjerrjen e titullit ekzekutiv për vjeljen e gjobave .

Të gjitha degët rajonale vazhdojnë punën me nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit me qëllim vjeljen dhe arketimin e gjobave. Gjatë vitit 2020, janë arkëtuar 84 gjoba nga të cilat 31 janë të vitit 2020, pjesa tjetër janë gjoba të viteve të mëparshme.

Departamenti i burimeve njerëzore.

Situata e krijuar në vend nga përhapja e COVID-19 që në Mars 2020, solli ndryshime dhe në mënyrën e organizimit të punës. Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ndërmorën një sërë masash dhe vazhdojnë ti përditësojnë ato, në kuadër të parandalimit të përhapjes së këtij virusi, ku dhe Inspektorati i Punës, si një institucion ekzekutiv në ndjekje të zbatimit të këtyre masave hartoi dhe miratoi urdhëra mbi organizimin dhe vazhdimin e punës duke qenë në koherencë me urdhërat dhe udhëzimet e dala nga qeveria, me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit në ambientet e punës.

Lëvizje paralele

1. 1 inspektor në Shkodër kalon me lëvizje paralele në Pozicionin Kryeinspektor në Shkodër.
2. 1 inspektor në Fier kalon me lëvizje paralele në pozicionin Kryeinspektor në Fier.

Emërimet

Janë emëruar 24 nëpunës sipas procedurave të DAP, përkatësisht në degët rajonale dhe pozicione;

- 1 inspektor në Dibër
- 5 inspektorë në Durrës
- 1 inspektor në Durrës (transferim i përhershëm)
- 1 inspektor në Berat (transferim i përhershëm)
- 1 inspektor në Fier
- 3 inspektorë në Gjirokastrë
- 2 inspektorë në Korçë
- 3 inspektorë në Elbasan
- 3 inspektorë në Vlorë (Sarandë)
- 1 Drejtor Drejtorie në Drejtorinë Qendore të ISHPSHSH-së
- 1 Kryeinspektor në Degën Rajonale të ISHPSHSH-së, Qarku Lezhë, (transferim i përhershëm).

Largimet

- 1 inspektor në Korçë me dorëheqje (student ekselence)
- 1 inspektor në Korçë me dorëheqje
- 1 inspektor në Durrës me dorëheqje (student ekselence)
- 1 inspektor në Dibër me dorëheqje (student ekselence)
- 1 Inspektor në Berat, ka plotësuar moshën për pension
- 1 Kryeinspektor në Tiranë larguar me masë disiplinore
- 1 Pëgjegjës Sektori Juridik kalon në një pozicion në një institucion tjetër
- 1 Kryeinspektor në Berat ka kërkuar pezullim statusi NC.
- 1 Kryeinspektor në Kukës ka kërkuar pezullim statusi NC.

Punonjësit mbështetës

Për punonjësit mbështetës,

1. Larguar 1 punonjës (nëpunës informacioni) me dëshirë
2. Emëruar 1 punonjës, nëpunës informacioni
3. Larguar për shkak të daljes në pension 1 punonjës pastrimi
4. Emëruar 1 punonjës pastrimi

Vendet vakante

Aktualisht për 12 mujorin 2020 rezultojnë 8 vende vakante;

- 1 (një) Kryeinspektor në Durrës
- 1 (një) Kryeinspektor në Tiranë
- 1 (një) Kryeinspektor në Berat (pezullim statusi)
- 1 (një) Kryeinspektor në Kukës (pezullim statusi)
- 1 (një) inspektor në Korçë
- 1 (një) inspektor në Dibër
- 1 (një) Inspektor në Fier
- 1 (një) Inspektor në Shkodër

Masat disiplinore

Gjatë 12 mujorit 2020 janë marrë këto masa disiplinore;

- 1 Inspektor në Elbasan ("Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 3 mujore")
- 1 Specialist në Drejtorinë Qendrore ("Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 12 mujore")
- 2 Inspektor në Tiranë ("Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 3 mujore")
- 2 Inspektor në Tiranë ("Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 12 mujore")
- 1 Kryeinspektor në Tiranë "Largim"

Trajnimet

Gjatë vitit 2020 janë kryer 2 seanca Trajnimi nga Drejtoria Qendrore për inspektorët e rinj, për temat;

- ✓ Hartimi dhe përpunimi i të dhënave Statistike të Inspektiveve të kryera nga Inspektorët e Degës Rajonale Tiranë.
- ✓ Procesi i Inspektimit

- ✓ "Mbi procesin e Inspektimit ne lidhje me Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, konkretisht mbi Këshillin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, Mjekun e Ndërmarrjes dhe Dokumentin e Vlerësimit të Riskut",
- ✓ "Mbi procesin e Inspektimit ne lidhje me hetimin e administrativ te aksidenteve ne punë".
- ✓ "Mbi veprimet praktike, per parandalimin e perhapjes te COVID-19 në vendet e punës", **40 inspektorë.**
- ✓ "Trajnime për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë në kuadër të ËGEP-COVID-19", **20 inspektorë.**

ASPA

- ✓ "Njohuri bazë të statistikave zyrtare", **3 inspektore** (1 përgjegjës dhe 2 inspektorë).
- ✓ "Sjellja Organizative", **3 inspektore** (1 përgjegjës dhe 2 inspektorë)
- ✓ "Analiza gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore në Administratën Publike",
 - **3 inspektore** (1 përgjegjës dhe 2 inspektore).
- ✓ Janë trajnuar tek ASPA 5 (pesë) inspektorë të cilët kanë plotësuar periudhën e provës dhe kanë kryer "Trajnimin e detyrueshëm për praninë në Shërbimin Civil".
- ✓ Është bërë ndjekja e Eëbinareve online nga nëpunësit e institucionit të zhvilluar nga Shkolla e Administratës Publike.

Duhet theksuar se Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është në proces rishikimit, në zbatim të Urdhrit nr. 156, datë 24.11.2020 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore".

Departamenti i Financës

Përgjatë kësaj periudhe, qendrave, kryesisht atyre jopublike, i'u janë shpërndarë informacione, udhëzime e protokolle të funksionimit në kushtet e situatës epidemiologjike.

Të ardhurat e realizuara në total nga gjobat dhe kamatvonesat e gjobave për periudhën Janar-Dhjetor 2020 janë 13.962.822lekë, nga të cilat: 13.381.123(trembëdhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e njëmijë e njëqind e njëzet e tre)lekë janë të ardhura nga gjobat dhe 581.699 (pesëqind e tetëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë)lekë janë të ardhurat nga kamatvonesat.

Ne tabelen e mëposhtme paraqitet buxheti vjetor 2020 me plan/realizime dhe diferenca.

Emërtimi	Plani Vjetor	Plan	Realizim	Diferenca +/-	Realizimi ne %
TOTALI BUXHETIT 2020	167.600.000	166.900.000	141.578.764	25.166.600	85
Paga Sigurime	133.864.000	133.864.000	120.721.396	13.142.604	90,18
Pagat me shtesat	115.278.000		103.488.783	11.789.217	
Sigurime Shoq, dhe Shëndetsore	18.586.000		17.232.613	1.353.387	

Investime	2.000.000	1.300.000	1.292.400	7.600	99,42
Investime	2.000.000	1.300.000	1.292.400	7.600	99,42
Mallra shërbime	31.436.000	31.436.000	19.419.604	12.016.396	61,78
Fond i vecante	300.000	300.000	145.364	154.636	48,45

Buxheti i miratuar për vitin 2020 është 186.600.000lekë. Me Aktin Normativ nr.15, datë 15.04.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, janë bërë pakësime në zërat e buxhetit, (art. 600+601), paga dhe sigurime në 6.500.000 lekë dhe në zërin art.buxheti 602 në 4.500.000 lekë, gjithashtu me Aktin normativ Nr.28 datë 02.07.2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.88/2019", Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, është bërë pakësim në investimeve në zërin e “Blerje automjete” në shumën 8.000.000lekë, sipas planit të rishikuar të buxhetit me Aktin Normativ Nr.34, datë 16.12.2020” pakesohet me 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, në zërin e investimeve pas këtyre ndryshimeve buxheti vjetor plani i periudhës është 166.900.000 (njëqind e gjashtëdhjet e gjashtëmilionë e nëntëqind mijë) lekë.

Theksojme se mungesa e stafit të nevojshëm administrativ dhe situata e krijuar në vazhdimësi, nga Pandemia Covid-19 ka shkaktuar vonesa në prokurime dhe ne realizime sipas planit vjetor 2020.

Gjithashtu dëshirojmë të theksojmë se mosrealizimi i fondeve, ka ardhur për shkaqe objektive, por kjo nuk do të ndikojë në performacën e këtyre shpenzimeve në vijim.

AKTIVITETE

- Bazuar në Planit Operacional të vitit 2020 të institucionit, mbi rritjen e nivelit të zbatimit të legjislacionit në subjekte me numër të konsiderueshëm punëmarrësish, ku siguria në punë, kushtet e punës, marrëdhënie pune konform legjislacionit, prek një gamë të gjërë punëmarrësish si dhe punëmarrës të kategorive të vecanta, gjatë muajit mars u planifikuan inspektime kryesisht të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fasoneri. Referuar këtij plani, Dëgët Rajonale të ISHPSHSH kanë bërë pjesë të planifikimit të inspektimeve këtë kategori subjektësh, në të cilat u zhvillua fushata ndërgjegjësuere në subjektet fason, me fokus mbrojtjen e marrëdhënies së punësimit të gruas. Ky aktivitet u zhvillua nën drejtimin e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së.
- Gjatë vitit ISHPSHSH-ja ka qënë pjesë aktive, në tryezat e rrumbullakta dhe takime të ndryshme të organizuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO, Qendra e Aleancës Gjimore e Zhvillim, Qendra për të Drejtat në Punë, Together for Life, Qendra Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, për promovimin dhe ndërgjegjësimin publik në raport me zbatueshmërinë e legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe të gjithë Legjislacionit të Punës në tërësi. Në takim me biznesin kemi marrë pjesë në ëbëbinarin Albanian Business Services Association me temë “Efektet e pandemisë në ekonominë e bizneseve Shqiptare dhe ndërmarrjen e masave lehtësuere për ta tejkaluar atë”.
- Gjatë këtij viti jo vetëm nuk ka munguar por për shkak dhe të sistuatës së krijoj pezullimi i punës së bizneseve për marrjen dhe respektimin e masave anticovid, ISHPSHSH-ja me stafin e vet ka qënë prezente në shumë media, emisione televizive duke ndërgjegjësuar punëdhëns e punëmarrës, mbi situatën e sigurisë në punë tashmë dhe në kushte të reja diktuar nga pandemia, duke promovuar kulturën parandaluese të cdo konflikti apo incidenti në vendin e punës.
- Në vecanti, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore gjatë vitit 2020, përcaktoi si prioritar bashkëpunimi me UNICEF, me qëllim forcimin kapaciteteve inspektuese. U realizuan periodikisht takime informuese, lobuese, të cilat në Nëntor 2020 u finalizuan me dakortësimin e partneritet me UNICEF. Ai do të mbështesë Drejtorinë e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, si një nga aktorët kryesorë të reformës së shërbimeve shoqërore, në disa drejtime, si:
 - Pjemarrja dhe përfshirja e ekspertizës së inspektimit të shërbimeve sociale në të gjitha forumet, tryezat, grupet e punës, që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale, zhvillimin e politikave sociale, (*Këshilli Konsultativ Qendror–Lokal i drejtuar nga MB/Agjensia e Qeverisjes Lokale; IMPG i bashkëdrejtuar nga MFE dhe MSHMS, etj*)
 - Përgatitja e Standartet e punës dhe të inspektimit të strukturave të përkujdesit social të bashkive dhe trajnimi i aktorëve.
 - Zhvillimi i 3 ëorkshop rajonale dhe 1 kombëtar.
 - Lobimin në instancat vendimmarrëse për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 121/2016, akte të lidhura me strukturën dhe funksionet e inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

- Përgjatë vitit 2020, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, në koordinim dhe me drejtorit e tjera, dërgoi në afat, informacione, të dhëna dhe raporte të kërkuara nga MFE, MEPJ, Departamenti Shtetit të SHBA, Ambasada e SHBA Tiranë, OSCE, etj. Ndër të tjera veçojmë raportimet lidhur me:
 - Kartën Sociale Europiane, (neni 3 dhe neni 7, pika 7.1, 7.3);
 - Progres Raportin për Kapitullin 19;
 - Për monitorimin e Akteve nënligjore;
 - Raportet periodik me kontriutit të ISHPSHSH-së për punën e fëmijëve, (mbrojtja dhe përkujdesi social);
 - Raportet periodik me kontributin e ISHPSHSH-së në kuadër të luftës kundër trafikimit të personave, (mbrojtja dhe përkujdesi social i viktimave);

- Bashkëpunimi me MSHMS, si ministria përgjegjëse për mbrojtjen dhe kujdesin social.

Edhe përgjatë vitit 2020, pavarësisht faktit, që janë bërë në mënyrë të herëpashërëshme propozimet përkatëse për nxitjen e procedurave përkatëse për hartimin dhe planifikimin e miratimit të akteve, të nevojshme për funksionimin dhe forcimin e Inspektoriatit të Kujdesit Shoqëror, edhe pas 5 vitesh nga hyrja në fuqi e Ligjit 121/2016, marrëdhënjet e Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore me MSHMS-në mbeten bashkëpunuese dhe jo varësie, gjë që ka vështirësuar rolin e kësaj Drejtorie, (inspektimit të shërbimeve të kujdesit social), si një nga aktorët më të rëndësishëm të reformës sociale.

PROBLEMATIKAT E HASURA

Inspektimet e realizuara na vënë në vëmendje rritjen e **ndërgjegjësimit** mbi detyrimin ligjor për marrje **leje nga inspektori i punës**, para vënies në punë të ndërmarrjes apo të një pjese të saj, si dhe për çdo ndryshim të rëndësishëm në mënyrën e punës, prodhimet e përdorura, makineritë dhe pajisjet siç parashikohet në Kodin e Punës dhe VKM përkatëse. Mos njohja e kësaj procedure, rrit propabilitetin e ndodhjes së aksidenteve në punë (si edhe ka rezultuar, që asnjë nga subjektet tek të cilat ka ndodh aksident në punë nuk ka bërë kërkesë për leje pune nga inspektori i punës); si dhe sjell shmangien nga inspektimi dhe mos monitorim të vazhdueshëm nga inspektorët e punës. Nga ana tjetër, kjo problematikë nuk është konstatuar shpesh herë as nga inspektorët e punës si shkelje, edhe në rastet kur ka ardhur një dëm, si rastet e aksidenteve në punë.

Vëmendje edhe për punëmarrësit e punësuar nga **Agjencinë Private të Punësimit**, të cilat të jenë objekt planifikimi për inspektimi nga ISHPSHSH, duke qenë se ka detyrimin ligjor për të kontrolluar veprimtarinë e tyre .

Mos njoftimi në kohë sipas ligjislacionit i rasteve të **aksidenteve** në punë, por të **raportuara me vonesë** pranë ISHPSHSH-së, sjell numër punëmarrësish që u mohohet e drejta e përfitimit në kohë nga skema e sigurimeve shoqërore, pasi ju duhet të ndjekin kalvarin e gjatë të gjyqeve.

Mos funksionimi i **organizimit sindikal**, sjell një njohje të ulët të të drejtave të punëmarrësve dhe të mbrojtjes së tyre. Kjo dikton që inspektimi i punës të ketë në fokus subjektet që kanë numër të konsiderueshëm punëmarrësish dhe sidomos femra.

Këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë nuk janë efektive, gjë që gjeneron në të shumtën e rasteve ankesa individuale të punëmarrësve.

Pavarësisht trajnimeve të vazhdueshme nga Drejtoria Qendrore, mungon një **sistem fillestar dhe i vazhdueshëm trajnimi** për inspektorët e punës dhe inspektorët e rinj.

Numër i vogël i inspektorëve të punës me qëllim një shtrirje më të madhe të subjekteve të inspektuara. Sugjerohet të zhvillohet edhe ‘vetedeklarimi i subjekteve‘ i cili nuk është një heqje dore nga inspektimi, por mënyrë e inspektimeve smart.

Mosndjekia e detyrave të lëna në inspektimet e mëparshme dhe mos aplikimi si detyrë të subjekteve që përveç të tjerave të raportojnë pranë ISHPSHSH-së për realizimin e detyrës, sic parashikon ligji i inspektimit. Kjo do lehtësonte edhe faktin e numrin të vogël të inspektorëve të të subjekteve të shumtë që duhet ti nënshtrohen inspektimit.

OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS

Anaziza e thelluar e problematikave që mbart inspektimi i punës, duke synuar e punar gjithmonë në përputhje me misionin e institucionit mbi rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së lëgjislacionit të punës nga ana e punëdhënësve e punëmarrësve, sjell në vëmendje objektiva të shtuara në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit të palëve ligjzbatuese përmes:

- I. *Vazhdimin e punës dhe zhvillimi më tej i platformës „matrica e dënime“, duke synuar që kjo platformë të jetë tashmë „platforma informuese e ndërgjegjësuere“, e aksesueshme dhe nga punëdhënës e punëmarrës në drejtim të marrjes së informacionit bazë mbi detyrimet e legjislacionit të punës.*

Ky ndërgjegjësim do të shërbejë në:

- ✓ Ndërhyrjen në kohë të inspektorit të punës si rregullator në krijimin e një **marrëdhënie të shëndoshë punësimi** duke ulur rastet e ankesave mbas ndërprerjes së një marrëdhënie pune, të destinuara të përfundojnë në gjykatë dhe shpesh herë dhe jo me zgjidhje për palët e dëmtuara.
- ✓ Marrjen e masave në kohën e duhur për **zhvillimin e punës në kushte të sigurta**, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në uljen e aksidenteve në punë.
- ✓ Njoftimin dhe **trajtimin në kohë të rasteve të aksidenteve**, duke ndjekur linjën ligjore e duke ndikuar në përfitimet e punëmarrësve të aksidentuar për shkak të punës.
- ✓ Vazhdimin e punës së nisur, dhe zhvillimin me tej të kësaj platforme, në rritjen e efektivitetit të inspektimit nëpërmjet **koordinimit e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku**:
 - ✓ Për inspektime në aktivitete të një **shkallë të lartë rrezikshmërie**
 - ✓ Për inspektime në aktivitete me **numër të konsiderueshëm punëmarrësish**
 - ✓ Për inspektime në aktivitete me **raste të përsëritura të ankesave apo aksidenteve**.
 - ✓ Për **zgjerimin e hartës** dhe mbulimit me inspektim të të gjithë teritorit të RSH, duke futur dhe konceptin e “Inspektimeve smart”, me qëllim këshillime e parandalime të abuzimit me ligjin.
 - ✓ Matjen e efektivitetit të një inspektimi dhe përmirësimit të situatës së nivelit të zbatimit të ligjit në subjekt, nëpërmjet monitorimit dhe **mbikqyrjes së inspektimeve online në kohë reale**.
 - ✓ **Shkëmbimit të të dhënave vlerësuese të kryqëzuara** me institucionet e tjera kontrolluese.

- ✓ **Adresim të problematikave** në lidhje me zbatueshmërinë e Legjislacionit të Punës dhe indicien e ndryshimeve ligjore të diktuar në kohë.

- II. *Zhvillimi dhe ngritja e një **bërthame me inspektor pune**, të mirë trajnuar për rastet e hetimit të aksidenteve në punë, si raste specifike inspektimi. Kjo njësi, do të shërbejë në trajnimin e përgjithshëm të inspektorëve të punës, duke rritur kapacitetet vëzhguese të inspektimit, si kyc e parandalues për ngjarje aksidentale në vendin e punës.*
- III. *Forcimi i bashkëpunimit me Institucionet e tjera të përfshira në një procedurë aksidenti apo gjatë çdo inspektimi ku del i nevojshëm ky bashkëpunim. Këtu vlen si risi, ngritja e **bashkëpunimit me qendrat spitalore**, për marrjen në kohë të njoftimit të rasteve të aksidenteve në punë për trajtim ligjor të cdo rasti.*
- IV. ***Ndërgjejësim i vazhdueshëm** për zbatimin e dispozitave të legjislacionit të punës nëpërmejt informimit, këshillimit, shpërndarjes së informacionit me anë të çdo burimi si (faqja e web, fletëpalosja, takime me partnerët social, fushata sensibilizuese, media).*
- V. *Rritja **kapaciteteve inspektuese** në drejtim të efikasitetit dhe cilësisë së inspektimit, zbatimi dhe dokumentimi korekt i procedurës inspektuese, me qëllim ndërhyrjet me masat ligjore të parashikuara nga këshillimi e deri tek ndëshkimi, duke synuar rritjen e nivelit të zbatimit të legjislacionit të punës nga punëdhënësi e punëmarrës.*
- VI. *Rritja e kontrolleve në **subjektet shtetërore** duke synuar minimizimin e konflikteve të marrëdhënieve të punës, si një trend në rritje ky kohët e fundit nga rastet e ankesave të adresuara pranë institucionit.*
- VII. *Forcimi i **bashkëpunimit** me institucionet e tjera si Tatim-Taksat, Sigurimet Shoqërore, AKPA, APP AMA, Komisioneri për Antidiskriminimin si dhe institucione të tjera, përmes shëmbimit të informacioneve reciproke.*
- VIII. *Forcimi i **kapaciteteve inspektuese** të Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, përmes implementimit të programit të Bashkëpunimit me*

UNICEF, ku Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, si një nga aktorët kryesorë të reformës së shërbimeve shoqërore, në partneritet me UNICEF, do të përfshijë dhënien e ekspertizës dhe promovimin e inspektimit të shërbimeve sociale në të gjitha forumet, tryezat, grupet e punës, që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale, zhvillimin e politikave sociale, si edhe në lidhje me rritjen e kapaciteteve të trupës inspektuese.

- IX. *Inspektimi i standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, **përmes garantimit të cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror**, ruajtja e nivelit të plotësimit të treguesve të standarteve përkatëse, respektimi i të drejtave të përfituesve, trajtimi i tyre me dinjitet dhe në përputhje me nevojat e vlerësuara të çdo individit në nevojë, për qendrat e përkujdesit, funksionale prej vitesh, dhe rritja e cilësisë së shërbimit për qendrat e reja të identifikuar, si edhe kudo ku përfituesi është, në qendër, në familje, në rrugë etj, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr.121/2016, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe Standartet e Përkujdesit Social të miratuara.*
- X. *Monitorimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror përfituese të Fondit Social bazuar në VKM Nr.150, datë 20.3.2019, “Për Metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social”.*
- XI. *Vazhdimi i **takimeve informuese** dhe rekomanduese për zhvillimet e strukturave përgjegjëse të kujdesit social në bashki, si dhe vlerësimi i shërbimeve të reja.*